



Pranimit / Datumit Prisje / Datum Received / Delivery	07.02.24	vit year	
Organ / Institucia Org / Inst	744/2024	Shifra / Index Appendix	119



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1535/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1535/2023 të datës 19.12.2023, të parashtruar nga ankuesi kundër Vendimit me Nr. Prot:8961 të datës 22.11.2023 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në çështjen juridike "Masë disiplinore-largim nga shërbimi civil", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 07.02.2024, unanimisht mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1535/2023 e datës 19.12.2023, e parashtruar nga ankuesi
- II. Mbetet në fuqi Vendimi me Nr.Prot: 8961 i datës 22.11.2023 i Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

A r s y e t i m

Ankuesi, më datë 19.12.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 7540/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.Prot:8961 të datës 22.11.2023 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 29.12.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës. Ndërsa më datë 03.01.2024 ka pranuar përgjigje në ankesë së bashku me provat lidhur me çështjen në procedurë.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke pasur parasysh natyrën specifike të lëndës më datë 29.01.2024 ka nxjerr vendim për shtyrjen e afatit të vendimmarrjes së ankesës së ankuesit për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me rastin e shqyrtimit të ankesës ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 7540/2023 e datës 19.12.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr. Prot: 8434 i datës 03.11.2023 i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës; Vendimin me Nr. Prot: 8753 i datës 15.11.2023 i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës; Kërkesë për marrjen e masave disiplinore e datës 20.11.2023; Vendimin me Nr. Prot: 8961 të datës 22.11.2023 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës; Aktgjykim PAKR.603/2015 i Gjykatës së Apelit të Kosovës; Certifikatën mbi dënimet penale e datës 22.11.2023; Vendimin A.nr.77/2019 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin Ref. 7608 i datës 03.10.2017 i Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Infrastrukturës; Vendimin me Nr. prot: 7757 të datës 09.10.2017 i u.d Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Infrastrukturës; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 29.12.2023; Përgjigjen në ankesë e datës 03.01.2024; Procesverbalin e Komisionit Disiplinor i datës 21.11.2023; Akt Emërimit e datës 26.12.2014; Emailin e datës 21.11.2023 nga A.K për N.A dhe L.O; Emailin e datës 22.11.2023 nga P.S për I.B,N.K,F.Q,E.S.S.F,A.N,V.S,A.K,L.O dhe N.A; Emaili i datës 11.01.2024 dërguar nga I.B për A.B; Emaili i datës 12.01.2024 dërguar nga A.B për A.Z; Emaili i datës 12.01.2024 i dërguar nga A.Z për A.B; Vendimin e shtyrjes së afatit të vendimmarrjes i datës 29.01.2024.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejshëm Kolegji i Këshillit) pasi ka shqyrtuar provat që janë dorëzuar nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankuesit është e pabazuar, *sepse*:

Nga provat materiale të lëndës, Kolegji i Këshillit, ka konstatuar se më datë 20.11.2023 zv. Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës ka parashtruar kërkesë për marrjen e masave disiplinore ndaj ankuesit pranë Komisionit Disiplinor të Ministrisë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Komisioni Disiplinor i Ministrisë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës më datë 22.11.2023 ka nxjerr Vendimin me Nr.Prot:8961 me të cilin ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore "Largim nga Shërbimi Civil".

Në kuptim të vendosjes lidhur me këtë çështje juridiko-administrative, Kolegji i Këshillit, i'u referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrarët Publikë përkitazi me rregullimin e procedurës dhe përgjegjësinë disiplinore të nëpunësve civil, gjegjësisht Kolegji i Këshillit me rastin e vendosjes mori për bazë :Nenin 55, i cili përcakton: "1. Nëpunësja/i civil mban përgjegjësi disiplinore për shkelje të detyrave dhe përgjegjësi, në rastet kur nuk kryen detyrat që i janë dhënë, kur bën zbatim jo të duhur të tyre apo kur gjatë ushtrimit të tyre vepron në kundërshtim me Kushtetutën, ligjet dhe akte të tjera nënligjore në fuqi. Shkelja disiplinore mund të bëhet me veprim apo mosveprim", nenin 56, i cili parasheh: "1. Shkeljet e detyrave dhe përgjegjësi të punës mund të jenë: 1.1. shkelje të lehta; 1.2. shkelje të rënda. 2. Shkeljet e rënda të detyrave dhe përgjegjësi të punës janë të përcaktuara me ligj, ndërsa shkeljet e lehta janë të përcaktuara me ligj dhe rregulla të brendshme. 3. Shkelje të lehta konsiderohen: 3.1. mungesa e paarsyeshme në punë deri në dy (2) ditë pune radhazi; 3.2. mosrespektimi i orarit të punës; 3.3. sjellja jo e mirë gjatë kohës së punës, me mbikëqyrëset/it, koleget/ët, vartëset/it dhe me publikun; 4. Shkelje të rënda konsiderohen: 4.1. mospërbushja e detyrave të punës; 4.2.

neglizhencë e vazhdueshme në përmbushje të detyrave të punës; 4.3. mosrespektimi i afateve të caktuara për përmbushjen e detyrave të punës; 4.4. moszbatimi i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale; 4.5. veprimet apo mosveprimet që kanë shkaktuar pasoja; 4.6. shkelja e rregullave të përcaktuara në kodin e etikës; 4.7. sjellje e papërshtatshme që dëmton reputacionin e shërbimit civil; 4.8. vënia në lajthilje e organit publik përmes dhënies së informatave të gabuara ose fshelja e të dhënave zyrtare kur kërkohen për qëllime zyrtare; 4.9. përfitimi apo ofrimi në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dhuaratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale që ndodhin për shkak të detyrës; 4.10. braktisja e punës ose muungesa e paarsyeshme dhe e vazhdueshme për tri (3) ose më shumë ditë pune; 4.11. përsëritja e shkeljeve të lehta disiplinore dy (2) apo më shumë herë; 4.12. moslajmërimi i shkeljeve të rënda që lidhet me detyrat e punës nga nëpunësjafi civil; 4.13. dëmtimi i pasurisë shtetërore, përdorimi i saj jashtë përcaktimit zyrtar apo keqpërdorimi i pasurisë shtetërore; 4.14. shkelja e rregullave për ruajtjen e informacionit dhe dokumenteve të klasifikuara; 4.15. përdorimi i narkotikëve dhe substancave të tjera narkotike të ndaluara; 4.16. përdorimi i alkoolit në vend të punës ose ardhja e/i delhur në punë; 4.17. keqpërdorimi i detyrës zyrtare lidhur me procedurën e rekrutimit nga anëtarët/ët e komisionit të rekrutimit që janë shërbyes civil; 4.18. ngacmimet në vendin e punës apo gjatë ushtrimit të detyrës, që cenojnë integritetin moral dhe fizik, si dhe ato seksuale; 4.19. diskriminimi mbi baza gjinore, racore dhe të tjera, sipas Ligjit përkatës Kundër Diskriminimit; 4.20. shkelja e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi”, nenin 57, i cili specifikon se: “1. Masat disiplinore, të cilat mund të shqiptohen ndaj nëpunësës/it civil për shkelje të lehta janë: 1.1. vërejtje verbale; 1.2. paralajmërim me shkrim; 1.3. vërejtje me shkrim. 2. Masat disiplinore, të cilat mund të shqiptohen ndaj nëpunësës/it civil për shkelje të rënda janë: 2.1. ndalimi nga njëzet për qind (20%) deri në pesëdhjetë (50%) e pagës bazë për një periudhë deri në gjashtë (6) muaj; 2.2. ndalimi i avancimit/emërimit në kategori më të lartë, për një periudhë nga një (1) deri në pesë (5) vite; 2.3. transferimi në pozitë të ngjashme në klasë dhe kategori të njëjtë; 2.4. ulja në pozitë; 2.5. pezullimi nga pozita pa pagesë deri në gjashtë (6) muaj; 2.6. pezullimi nga pozita me ndalim deri në pesëdhjetë për qind (50%) të pagës bazë, deri në një (1) vit; 2.7. largimi nga shërbimi civil”.

Duke u bazuar në këto dispozita ligjore, Kolegji i Këshillit sa i përket Vendimit me Nr. Prot: 8961 të datës 22.11.2023 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, ka konstatuar se Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës më rastin e nxjerrës së Vendimit me Nr. Port: 8961 të datës 22.11.2023, ka vepruar në pajtim me nenin 55 paragrafi 1, 56 paragrafi 4 nën paragrafi 4.7, nenin 57 paragrafi 2 nën paragrafi 2.7, nenin 58 paragrafi 2, nenin 61 paragrafi 1, 2 dhe 4 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, për rrjedhojë pretendimet ankimore të ankuesit janë të pabazuara.

Bazuar si më lartë, Kolegji i Këshillit duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.



KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.1535/2023, datë 07/02/2024

Avdyll BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

